



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtë për politikë publike nr.22/2020


-

**Diskutime të zbrazëta ose fjalime
bazuar në arsyetim të qartë:
Analizë krahasuese e nivelit të
argumentimit të diskutimeve në
Parlamentet e Maqedonisë së Veriut,
Sllovenisë dhe Parlamentin Evropian**

Autorë: Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq dhe Sara Janeska

-

maj 2020



Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP implementohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbajtja e botimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e SDC-së.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	1
I. Shqyrtimi i literaturës: Argumentimi i debateve të deputetëve në parlament	2
Matja e cilësisë së debatit në parlamentet	2
Shkalla e argumentimit të fjalimeve të deputetëve të Parlamentit Evropian	2
Shkalla e argumentimit të fjalimeve të deputetëve të Parlamentit të Republikës së Sllovenisë	3
II. Argumentimi i debateve të deputetëve në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut	4
Shkalla e (jo) argumentimit të fjalimeve të deputetëve nga përbërja e fundit parlamentare (2016 - 2020)	4
Perceptimi i qytetarëve për shkallën e argumentimit në debatet parlamentare	5
III. Ku qëndron argumentimi i diskutimeve në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë në krahasim me parlamentet e tjera?	6
Përfundim	7
Bibliografia	8

Hyrje

Vendimet në Parlament miratohen përmes debateve parlamentare. Çdo vit, deputetët kalojnë orë të gjata në Parlament, duke diskutuar në lidhje me ligjet e propozuara, raportet dhe prononcimet e përfaqësuesve të tjerë shtetërorë dhe përfaqësues të qeverisë. Të gjitha debatet kanë të bëjnë me çështje të cilat janë me rëndësi kombëtare ose ndërkombëtare, ndërsa vendimet që merren në mënyrë të drejtpërdrejtë e formësojnë jetën e qytetarëve dhe pozitën ndërkombëtare të shtetit.

Përfshirja e deputetëve në debatet në parlament, ka për qëllim të justifikojë ose të hedhë poshtë një mendim të veçantë dhe të bindin kolegët deputetë, në pozicionet që ata përfaqësojnë. Kështu, qëllimi përfundimtar i çdo fjalimi nga ana e deputetëve, është vendimi i Parlamentit të jetë në drejtim të pozitave të tyre. Prandaj, debatet duhet të bazohen në argumente dhe prova të paraqitura nga deputetët në mbështetje të fjalimeve të tyre, në mënyrë që vendimi të merret nga një shumicë e informuar.

Qëllimi i kësaj analize është të tregojë nivelin e argumentimit në diskutimet e deputetëve nga përbërja e fundit parlamentare (2016 - 2020) e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Niveli i argumentimit në Parlamentin e Maqedonisë do të krahasohet gjithashtu me nivelin e argumentimit të debatit në Parlamentin Evropian dhe në Parlamentin e Republikës së Sllovenisë. Këto dy parlamente janë zgjedhur si institucione referencë

për shkak të aspiratave të Maqedonisë së Veriut, për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE). Në këtë mënyrë, do të bëhet një prezantim mbi argumentet e debatit në Parlamentin tonë në raport me Trupin Parlamentar të BE-së, por edhe në raport me Parlamentin e Sllovenisë, si anëtare e BE-së nga rajoni, me të cilin kemi ngjashmëri të rëndësishme nga pikëpamja historike dhe politike.

I. Shqyrtimi i literaturës: Argumentimi i debateve të deputetëve në parlament

—

Matja e cilësisë së debatit në parlamentet

Për shkak të peshës së vendimeve të cilat miratohen përmes debateve të deputetëve, Stenbergen dhe bashkëpunëtorët e tij kanë zhvilluar një instrument të quajtur Indeksi i cilësisë së debatit (ICD), i cili jep një vlerësim përfundimtar të cilësisë së përgjithshme të diskutimit në parlamentet. Ky Indeks parashikon monitorimin e disa indikatorëve që vlerësojnë mënyrën dhe nivelin në prezantimin e pozitave, si dhe në sjelljen e vetë deputetëve. Disa nga treguesit që monitorohen përmes ICD janë niveli i argumentimit, ndërprerjet gjatë prezantimeve, qëndrimi ndaj pjesëmarrësve të tjerë në debat, përfshirja e arsyetimit dhe të tjera.¹

ICD është aplikuar më shumë herë në parlamente të ndryshme, përfshirë Parlamentin Evropian, dhe parlamentet e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Sllovenisë. Niveli i argumentimit, gjegjësisht arsyetimi dhe mbështetja e qëndrimeve të shprehura nga deputetët, që si indikator mbulohet me ICD analizat e këtyre tre vendeve, është veçuar si një pikë interesi e kësaj analize.

Shkalla e argumentimit të fjalimeve të deputetëve të Parlamentit Evropian

Për të demonstruar cilësinë e debatit ndërmjet anëtarëve të Parlamentit Evropian, Lord dhe Tamwaki, e përshtat ICD, dhe të njëjtin e aplikojnë në gjithsej 32 nga 84 debatet plenare të mbajtura nga Parlamenti Evropian në 6 tema në periudhën 2004-09².


Në lidhje me nivelin e argumentimit në fjalimet e deputetëve, si një nga treguesit që janë monitoruar, autorët në analizën e tyre vunë në dukje se shumica e fjalimeve të deputetëve përfshijnë një ose dy argumente në të cilat, në mënyrë eksplicite tregohen arsyet për pozicionimet e tyre. Përkatësisht, kjo ka ndodhur në 58% të fjalimeve të euro deputetëve. Nga ana tjetër, në 43% e fjalimeve, është regjistruar argumentimi i dobët ose nuk ka pasur asnjë argumentim, nga të cilët në 10% nuk kishte argumentim, ndërsa në 33% argumentimi ishte i dobët (Grafiku 1)³.

¹ Steenbergen, Marco R., et al. "Measuring political deliberation: A discourse quality index." *Comparative European Politics* 1.1 (2003).

² Lord, Christopher, and Dionysia Tamvaki. "The politics of justification? Applying the 'Discourse Quality Index' to the study of the European Parliament." *European Political Science Review* 5.1 (2013).

³ Ibid

Grafiku 1. Shkalla e argumentimit të diskutimeve në Parlamentin Evropian (%)



Lord dhe Tamwaki, në mënyrë plotësuese theksojnë se me rezultate të tilla, Parlamenti Evropian është në linjë me nivelin e argumentimit në fjalimet e deputetëve në parlamentet kombëtarë, siç janë parlamenti anglez dhe gjerman. Megjithatë, ata gjithashtu vërejnë se krahasuar me Parlamentin Zviceran, ku niveli i cilësisë së argumentimit me një ose më shumë argumente arrin 80%, ekziston hapësirë e konsiderueshme për avancimin e fjalimeve në Parlamentin Evropian. Këtë dallim në argumentimin e diskutimeve ndërmjet Parlamentit Evropian dhe Parlamentit Zviceran, autorët e arsyetojnë edhe me faktin se, krahasuar me

deputetët e parlamentit zviceran, euro deputetët punojnë në një mjedis më kompleks, ku diversiteti i gjuhësor, kultura politike dhe lloji i demokracive kombëtare nga vijnë, ndikojnë në mënyrë kufizuese mbi fjalimet dhe argumentimin⁴.

Shkalla e argumentimit të fjalimeve të deputetëve të Parlamentit të Republikës së Sllovenisë

Përshtatje të ICD kanë bërë Kuhar dhe Petroviq, dhe e kanë aplikuar mbi debatet në Parlamentin Slloven, në lidhje me Kodin (ligjin) e Familjes për periudhën 2009-2011.⁵

Duke analizuar, ndër të tjera, nivelin e argumentimit në fjalimet e deputetëve, Kuhar dhe Petroviq, arrijnë në përfundimin se 77% e fjalimeve të deputetëve përmbajnë së paku një argument me të cilin e sqarojnë pozitën e tyre. Nga ana tjetër, 23% e fjalimeve janë argumentuar dobët (15%) ose nuk u argumentuan aspak (8%, Grafiku 2).⁶

Ky nivel i argumentit në parlamentin slloven është mjaft afër nivelit në Parlamentin Zviceran, për të cilin Lord dhe Tamwaki, vërejnë se është në vetë majën / kulmin, kur bëhet fjalë për diskutim të argumentuar⁷. Së këndejmi, mund të konkludohet se deputetët në Slloveni përdorin numër të konsiderueshëm, më të madh të argumenteve në fjalimet e tyre, në krahasim me kolegët e tyre në Parlamentin Evropian.

⁴ Ibid


⁵ Kuhar, Metka, and Andraž Petrovič. "The Quality of Parliamentary Deliberation: The Case of the Family Code Debates in the Slovenian Parliament." *Javnost-The Public* 24.1 (2017).

⁶ Ibid

⁷ Lord, Christopher, and Dionysia Tamvaki. "The politics of justification? Applying the 'Discourse Quality Index' to the study of the European Parliament." *European Political Science Review* 5.1 (2013).

Grafiku 2.

Shkalla e argumentimit të diskutimeve në Parlamentin e Sllovenisë



plenare në fushëveprimin e të cilave bëjnë pjesë fushat e lartë përmendura.

Bazuar në rezultatet e monitorimit të debateve të përbërjes së fundit parlamentare, në periudhën 2017-2019, mund të konkludohet se fjalimet e deputetëve në përgjithësi ishin me argumentim të dobët ose nuk ishin aspak të argumentuara. Përkatesisht, ky është rasti në rreth 75% të fjalimeve të tyre në periudhën e monitoruar. Në mënyrë më të detajuar, mund të vërehet se fjalimet në të cilat nuk u paraqit asnjë argument, mesatarisht është rreth 30% ndërsa fjalimet në të cilat deputetët kanë ofruar arsyetim për pozicionet e tyre i cili nuk është i mjaftueshëm për t'u konsideruar si argument i plotë është rreth 45%. Deputetët ofruar një ose më shumë argumente, në 26% të fjalimeve të tyre në Parlament. (Grafiku 3)⁸.


II. Argumentimi i debateve të deputetëve në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shkalla e (jo) argumentimit të fjalimeve të deputetëve nga përbërja e fundit parlamentare (2016 - 2020)

Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) ka monitoruar cilësinë e debatit në Parlament përmes ICD-së që nga viti 2014. Monitorimi përqendrohet në diskutime mbi çështjet të cilat janë pika nga rendi i ditës së parlamentit, të cilat bëjnë pjesë në fushat e sundimit të së drejtës, të drejtat e njeriut dhe demokracia. Në këtë drejtim, monitorohen ato trupa pune të Kuvendit dhe seancat

Grafiku 3.⁸

Shkalla e argumentimit në diskutimet e parlamenteve të Republika e Maqedonisë së Veriut



⁸ Vlerat mesatare për periudhën 2017 - 2019, nga raportet:
[IDSCS. Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, maj - gusht 2017" \(2017\)](#)
 IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, shtator-dhjetor 2017" (2018)
 IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, Janar - Qershor 2018" (2018)
[IDSCS. "Извештај од набљудувањето на квалитетот на дебатата во Собранието, јул - дек 2018" \(2019\)](#)
[ИДСЦС. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, Janar - Qershor 2019" \(2019\)](#)
[IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, korrik - dhjetor 2019" \(2020\)](#)

Perceptimi i qytetarëve për shkallën e argumentimit në debatet parlamentare


Proceset demokratike inkurajojnë qytetarët të formojnë mendime për një numër të konsiderueshëm të çështjeve nga sfera politike në shtet. Perceptimet e qytetarëve janë agjent i fuqishëm i ndryshimeve, duke krijuar presion shtesë mbi institucionet politike, sepse i formësojnë rezultatet e zgjedhjeve dhe çojnë drejt zgjedhjes ose rënies së strukturave qeverisëse.

Në periudhën 2009-2019, IDSCS në vazhdimësi e monitoron edhe perceptimin e qytetarëve për punën e Parlamentit. Një nga pyetjet e paraqitura në sondazhet, ka të bëjë me mendimin e qytetarëve rreth asaj se sa përdorin deputetët argumente dhe arsytetime në fjalimet e tyre.

Gjegjësisht, rezultatet tregojnë se perceptimi i qytetarëve në lidhje me këtë temë është në përputhje me atë se sa realisht përdorin deputetët argumente në fjalimet e tyre. Rreth gjysma e qytetarëve vazhdimisht kanë një perceptim negativ, përkatësisht ata mendojnë se deputetët e përbërjes së fundit parlamentare, rrallë ose asnjëherë nuk përdorin argumente në fjalimet e tyre. Nga ana tjetër, përqindja e qytetarëve që mendojnë se deputetët shpesh ose gjithmonë i referohen argumenteve kur paraqesin pozicionet e tyre është rreth 42% (Grafiku 4)⁹.

Grafiku 4.

Sa shpesh përdoren argumente në debatin ndërmjet deputetëve në Kuvend?



⁹ Vlerat mesatare për periudhën 2018 - 2020, nga raportet: IDSCS. "Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" (2018) [IDSCS. "Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" \(2019\)](#) IDSCS. "Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" (2020)

III. Ku qëndron argumentimi i diskutimeve në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë në krahasim me parlamentet e tjera?


Analiza krahasuese e shkallës së argumentimit të diskutimeve të deputetëve të Parlamentit Evropian dhe Parlamenteve të Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut, vëren se niveli i argumentimit të fjalimeve të deputetëve në Maqedoninë e Veriut, është dukshëm më i ulët.

Përqindja e fjalimeve në të cilat deputetët kanë ofruar të paktën një arsytim të plotë në lidhje me pozitën e tyre në Maqedoninë e Veriut është 26%, që është për 32 pikë të përqindjes më e ulët në krahasim me mesataren në Parlamentin Evropian

(58%), përkatësisht 51 pikë të përqindjes më e ulët se mesatarja në Republikën e Sllovenisë (77%). Në mënyrë përkatëse, dallim i konsiderueshëm vërehet në përqindjen e fjalimeve të deputetëve në të cilat nuk është përdorur asnjë argument i vetëm në mbështetje të fjalimit të tyre. Përqindja e fjalimeve të tilla në Parlamentin Evropian dhe Parlamentin e Sllovenisë është pothuajse e njëjtë dhe lëviz në shkallën 10% respektivisht 8% në mënyrë përkatëse. Nga ana tjetër, kjo situatë vërehet në pothuajse një të tretën e fjalimeve në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut (30%), përkatësisht është për rreth 20 pikë të përqindjes më e lartë se e Parlamentit Evropian dhe Parlamentit të Sllovenisë (Grafiku 5).

Sa i përket përqindjes së fjalimeve në të cilat deputetët kanë ofruar arsytim për qëndrimet e tyre që nuk është e mjaftueshme për t'u konsideruar si një argument i plotë, në Maqedoninë e Veriut (45%) është më e lartë për 12 pikë të përqindjes në krahasim me Parlamentin Evropian (33%), përkatësisht për 30 pikë të përqindjes më e lartë në krahasim me Parlamentin në Slloveni (Grafiku 5).

Grafiku 5. Shkalla e argumentimit në diskutimet e parlamenteve të: (%)



Përfundim

Kultura e debatimit të deputetëve në vendin tonë, e mbështetur me argumente të qarta dhe të forta me të cilat drejtpërdrejtë mbështetet qëndrimi i përfaqësuar, është në nivel dukshëm të ulët. Numri dominues i diskutimeve që u zhvilluan ndërmjet deputetëve nga përbërja e fundit paralele e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në periudhën 2017-2019, janë argumentuar dobët ose nuk janë argumentuar fare. Me fjalë të tjera, shumica e qëndrimeve që deputetët përfaqësuan në Parlament nuk ishin të bazuara në prova dhe nuk ishin ofruar shpjegime përkatëse në lidhje me to. Kjo situatë perceptohet në mënyrë objektive nga qytetarët, shumica e të cilëve realisht vlerësuan nivelin e ulët të argumentimit në fjalimet e deputetëve, duke vlerësuar se ata rrallë ose kurrë nuk përdorin argumente në fjalimet e tyre¹⁰.

Kjo situatë, e pozicionon Parlamentin e Maqedonisë së Veriut, shumë më poshtë se mesatarja e Parlamentit Evropian dhe Parlamentit të Sllovenisë. Përqindja e fjalimeve në të cilat deputetët e Maqedonisë së Veriut ofruan të paktën një arsytim në lidhje me pozitën e tyre është dy herë më e ulët se përqindja e euro deputetëve, dhe tre herë të konsiderueshme më e ulët, krahasuar me deputetët sllovenë. Në mënyrë përkatëse me këtë, përqindja e fjalimeve të deputetëve të Maqedonisë së Veriut, në të cilat nuk ofrojnë argumente adekuate për të mbështetur pozicionin e tyre është dy herë më e lartë se e kolegëve të tyre nga Parlamenti Evropian, ose tre herë më e lartë se e kolegëve të tyre nga Parlamenti Slloven.

Për këto shkaqe, **duhet të rritet cilësia e debatit dhe niveli i argumentimit të fjalimeve të deputetëve në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut.** Për arritjen e këtij qëllimi, deputetët i kanë në dispozicion disa mjete, por gjithashtu duhet edhe vendosja e masave dhe praktikave plotësuese.

Rritja e informimit dhe dijeve në lidhje me tema që janë lëndë e diskutimit, si dhe përmirësimi i aftësive për debat dhe aftësive oratore të deputetëve, në mënyrë të konsiderueshme do të mund të kontribuojnë për debat më cilësor në Kuvend. Instituti Parlamentar (IP) i cili funksionon në kuadër të Kuvendit, ofron shërbime me të cilat mund të adresohen këto nevojat të deputetëve. Përkatësisht, IP kryen hulumtime në tema me interes për deputetët si dhe realizon edukim dhe trajnim për fusha specifike. Për këto shkaqe, nevojitet përdorim më i madh dhe më efikas i shërbimeve të IP-së nga deputetët.

Kuvendi, duhet të përfshihet në proceset e Vlerësimit të ndikimit të rregullativës (VNRr), nëpërmjet çka, dukshëm do të rritej cilësia dhe argumentimi i diskutimeve. VNRr kontribuon drejt përmirësimit të cilësisë së vendimmarrjes për rregullat, sigurimin e informacioneve në lidhje me efektet dhe pasojat e masave të reja rregullatorë dhe bën vlerësimin dhe monitorimin e rregullativave ekzistuese. Ky mjet përdoret nga Qeveria, si propozuesi dominant i zgjidhjeve ligjore në shtet, por jo edhe nga Kuvendi. Për këto shkaqe, Kuvendi është vendosur në rolin e vlerësuesit

¹⁰ Vlerat mesatare për periudhën 2017 - 2019, nga raportet:
[IDSCS. Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, maj - gusht 2017 "\(2017\)](#)
[IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, shtator-dhjetor 2017" \(2018\)](#)
[IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, Janar - Qershor 2018" \(2018\)](#)
[IDSCS. |||UNTRANSLATED_CONTENT_START|||Извештај од набљудувањето на квалитетот на дебатата во Собранието, јул - дек 2018" \(2019\)](#)
[ИДСЦС. |||UNTRANSLATED_CONTENT_END|||"Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, Janar - Qershor 2019" \(2019\)](#)
[IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, korrik - dhjetor 2019" \(2020\)](#)

të propozimeve qeveritare, por në këtë rol është në mënyrë jo konsekuente, sepse argumentimi i deputetëve nuk fokusohet mjaftueshëm mbi përmbajtjen e rregullativave të propozuara ose diskutimi zhvillohet me argumentim të dobët¹¹. Së këndejmi, zbatimi i VNRr në Kuvend dhe zbatimi praktik aktiv i VNRr-së nga deputetët si propozues të zgjidhjeve ligjore, do të mundësojë diskutim më të argumentuar dhe miratimin e vendimeve të informuara.¹²

Deputetët nuk duhet të keqpërdorin procedurën e shkurtuar dhe flamurin evropian, për shqyrtimin e propozim – ligjeve.

Procedura e shkurtuar ose urgjente, zvogëlon kohën për debat, parasheh afate më të shkurta për përfundimin e diskutimit, ndërsa në disa raste votohet pa diskutim. Kufizimi i diskutimit në Kuvend, është parashikuar edhe për rregullativën tek e cila nevojitet flamuri evropian, me të cilën shënohet harmonizimi i ligjit me legjislacionin e Bashkimit Evropian¹³. Keqpërdorimi i këtyre kufizimeve në debatin ndërmjet deputetëve, negativisht reflekton mbi cilësinë e debatit, e shkurton të drejtën e fjalës së deputetëve dhe i privon nga marrja e vendimit të informuar. Keqpërdorimi i këtillë, pa dyshim rezulton me zgjidhje ligjore të përshpejtuara dhe të pa përshtatshme.

¹¹ Dimevski, Jane, "Debat me brinjë – analizë e cilësisë së diskutimit në Kuvend qershor 2014 – maj 2015", IDSCS, (2015), e qasshme në: <http://idscs.org.mk/wpcontent/uploads/2009/08/rovovska-debata-mk.pdf>

¹² Bliznakovski, Jovan "Praktika të mira krahasuese të shembujve të VNRr-së dhe mundësi për implementimin e tyre në Maqedoni", IDSDS, (2017), e qasshme në: <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/>

¹³ Dimitrievski, Dean "Miratimi i ligjit me procedurë të shkurtuar ose me procedurë urgjente" Instituti Parlamentar (2017) i qasshëm në: <https://www.sobranie.mk/content/PI/>

Bibliografia

Steenbergen, Marco R., et al. "Measuring political deliberation: A discourse quality index." *Comparative European Politics* 1.1 (2003).

Lord, Christopher, and Dionysia Tamvaki. "The politics of justification? Applying the 'Discourse Quality Index' to the study of the European Parliament." *European Political Science Review* 5.1 (2013).

Kuhar, Metka, and Andraž Petrovčič. "The Quality of Parliamentary Deliberation: The Case of the Family Code Debates in the Slovenian Parliament." *Javnost-The Public* 24.1 (2017).

IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, maj - gusht 2017" (2017)

IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, shtator-dhjetor 2017" (2018)

IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, Janar - Qershor 2018" (2018)

IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Parlament, korrik - dhjetor 2018" (2019)

IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, Janar - Qershor 2019" (2019)

IDSCS. "Raport mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, korrik - dhjetor 2019" (2020)

IDSCS. "Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" (2018)

IDSCS. "Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" (2019)

IDSCS. "Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" (2020)

Dimevski, Jane, "Debat me brinjë – analizë e cilësisë së diskutimit në Kuvend qershor 2014 – maj 2015", IDSCS, (2015),

Bliznakovski, Jovan "Praktika të mira krahasuese të shembujve të VNRR-së dhe mundësi për implementimin e tyre në Maqedoni", IDSCS, (2017),

Dimitrievski, Dean "Miratimi i ligjit me procedurë të shkurtuar ose me procedurë urgjente" Instituti Parlamentar (2017)



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtë për politikë publike nr.22/2020

**Diskutime të zbrazëta ose fjalime
bazuar në arsyetim të qartë:
Analizë krahasuese e nivelit të
argumentimit të diskutimeve në
Parlamentet e Maqedonisë së Veriut,
Sllovenisë dhe Parlamentin Evropian**

Autorë: Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq dhe Sara Janeska
maj 2020